

Shkathtësitë e buta në kurrikulin shkollor (ShB)

Tipi i Programit: Themelor

Historiku i Programit

Ideja e zhvillimit të këtij programi ka filluar në vitin 2017 me programin ASSET të USAID (Përkrahja e adoleshentëve pas mësimit të rregullt), qëllimi i të cilit ishte që të zhvillohen shkathtësitë e nevojshme për jetë dhe punë të nxënësve të moshës adoleshente. Në vitin 2018 u draftuan konceptet dhe termat kryesore të këtij programi, me kujdes të veçantë në ndërlidhjen e dokumentit me kërkesat e dalura nga kurrikuli i bazuar në kompetenca, i cili u diskutua me aktorë kryesor të arsimit në vend (MASH, Fakulteti edukimit, Instituti pedagogjik, dhe organizata tjera që merren me zhvillimin e arsimit), dhe si rezultat doli një draft dokument me dhjetë shkathtësi të buta dhe treguesit përkatës me të cilët matet arritja e tyre. Në vitin 2019 dokumenti u pilotua me një numër të konsiderueshëm të grupeve të mësimdhënësve gjatë zhvillimit profesional të tyre në dy programe, Mësimdhënia e bazuar në projekte dhe Vlerësimi për të nxënë. Të gjeturat treguan se dokumenti u pranua shumë mirë nga mësimdhënësit, të cilët përmes informatave kthyesë ndihmuan që materiali të kontekstualizohet dhe të bëhet sa më i realizueshëm për realitetin shkollor në vendin tonë. Poashtu, për shkak të rëndësisë së programit, dhe angazhimit që kërkohet për të përvetësuar dhe realizuar këtë dokument, mësimdhënësit kërkuan që ky material të përgatitet si program i veçantë për zhvillim profesional të tyre përmes të cilit do të fitohen pikë shtesë për licencimin e tyre. Në mars 2020 programi është aprovuar nga KShLM me kohëzgjatje një vjeçare. Në maj 2022 për këtë program janë certifikuar rreth 500 mësimdhënës të cilët ishin trajnuar më heret.

Qëllimet e programit:

Zhvillimi i shkathtësive të buta ka dal si nevojë në plotësimin e zhvillimit të elementeve përbërëse të kompetencave kryesore të kurrikulit shkollor, të cilat përveç elementeve të para që zakonisht përfshihen në realizimin dhe matjen e tyre përmes rezultateve mësimore të pritura në kurrikulë (*njohuri, shkathtësive dhe rutinave*), duhet përfshirë edhe *qëndrimet, sjelljet dhe vlerat* që duhet zhvilluar tek nxënësit për tu kompletuar si individ që është *kommunikues efektiv, mendimtar kritik, nxënës i suksesshëm, kontribues produktiv, individ i shëndetshëm dhe qytetar i përgjegjshëm*.

Qëllimi i këtij programi është që të aftësojë dhe vetëdijësojë mësimdhënësit se është e nevojshme që të zhvillohen, vlerësohen dhe raportohen arritjen e shkathtësive të buta tek nxënësit e tyre, përmes instrumenteve të caktuara. Materiali i këtij trajnimi poashtu përmban edhe instrument vetvlerësimi i cili do të përdoret nga vet nxënësit, dhe ata do ta përcjellin zhvillimin e tyre personal në mënyrë të matshme përmes treguesve të caktuar. Gjatë kursit synohet të zgjerohet këndvështrimi i mësimdhënësve për vlerësimin, duke e parë atë si një proces të vazhdueshëm që kontribuon në zhvillimin e kompetencave të përcaktuara në Kurrikulën e Kosovës.

Pjesëmarrësit në këtë program trajnues do të pajisen me rezultatet si në vijim:

- Kuptojnë rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive të buta tek nxënësit;
- Njohin përshkruesit e shkathtësive të buta dhe treguesit për secilën shkathtësi;

- Zbatojnë instrumentet për vlerësimin e shkathtësive të buta (mbajn librin e shënimeve për vrojtimin e nxënësve gjatë procesit mësimor; përcaktojnë kriteret e suksesit të nxënësit për një detyrë; sigurohen se nxënësit bëjnë vetëvlerësim përmes instrumentit të vetëvlerësimit);
- Plotësojnë instrumentet përmbledhëse për vlerësim të shkathtësive të buta të secilit nxënës;
- Bashkëpunojnë me kolegët tjerë / vlerësojnë në ekip gjatë plotësimit të instrumeteve përmbledhëse të shkathtësive të buta

Përmbajtja:

Programi i këtij trajnimi përmban një pako prej dhjetë ‘shkathtësive të buta’ / ‘shkathtësive për jetë dhe punë’ të cilat lidhen me jetën dhe punën e individit, përmes të cilave do të kontribuohet në zhvillimin e gjashtë kompetencave kryesore të përcaktuara me kurrikulën e Kosovës. Programi ASSET është i përqëndruar në punën me gjimnazet në 16 komunat partnere, por ky material është i përshtatshëm të përdoret edhe për të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar, sepse ndërlidhet shumë ngusht me zhvillimin e kompetencave kryesore të kurrikulit gjatë arsimit parauniversitar.

Lista e shkathtësive të buta mund të jetë shumë e gjatë, dhe relevanca e tyre mund të jetë e ndryshme në kontekste të ndryshme kohore dhe vendore, por në kuadër të këtij dokumenti janë përzgjedhur për t’u elaboruar vetëm dhjetë prej shkathtësive të buta sepse ndërlidhen më afër me kërkesat e kohës, e ato janë:

- Shkathtësia e të menduarit kritik;
- Shkathtësia e komunikimit;
- Shkathtësia e zgjidhjes së problemeve;
- Kreativiteti;
- Inteligjenca emocionale;
- Ndërgjegjshmëria;
- Këmbëngulësia;
- Puna ekipore;
- Shkathtësia e mbledhjes së informatave (hulumtuese);
- Shkathtësia për ndërmarrësi.

Grupi i synuar

Te gjithë mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta, gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave X, XI, dhe XII. Sipas kornizës së kurrikulit për arsim parauniversitar, të gjithë mësimdhënësit do të duhej të kenë njohuri për zhvillimin dhe vlerësimin e gjashtë kompetencave kryesore të kurrikulit (kompetencat: e komunikimit, e të menduarit, e të mësuarit, për jetë-punë-mjedis, personale, dhe qytetare), prandaj ky program synon të përfshijë të gjithë mësimdhënësit që janë në shërbim në arsimin parauniversitar e specifikuat atij të mesëm të lartë. Numri i pjesëmarrësve për këtë trajnim në të ardhmen nuk është i kufizuar, por në periudhën e ardhme varet nga interesimi i shkollave dhe komunave për ta fut në shfrytëzim. Në veçanti, do të jetë një vlerë e shtuar për të gjitha shkollat e niveleve tjera nëse me këtë kurs trajnohen së paku të gjithë koordinatoret e cilësisë në shkolla, të cilët pastaj mund të promovojnë zhvillimin dhe të vlerësuarit e shkathtësive të buta si pjesë e vlerësimit të gjashtë kompetencave kryesore të kurrikulit tek nxënësit.

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Pjesëmarrësit e këtij kursi, do të marrin pjesë në katër sesione (6 orë të plota) të moderuara me fasilitues shkollor, dhe një kohë e shpenzojnë për zbatim të njohurive të kursit me nxënës në klasë, e cila në kuptim kohor është ekuivalente me tetë sesione tjera (12 orë të plota). Kursi është i dizajnuar ashtu që të mund të ofrohet në sallë trajnimi ose në mënyrë virtuale nga distanca përmes platformave elektronike. Kjo përfshinë ndërveprim, plane mësimore / projekte mësimore, realizim me nxënës, prezantime, diskutime, punë individuale, dhe punë në ekip me kolegët tjerë mësimdhënës. Tërë procesi i trajnimit shtrihet në afat kohor prej 4-6 javësh. Gjatë kësaj periudhe pjesëmarrësit do të mentorohen dhe observohen në klasë nga fasilituesit e programit, që të përkrahen në përmbushjen e kërkesave për certifikim.

Vlerësimi/Certifikimi

Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit mësimdhënës do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 18 orë trajnimi (4 sesione x 90 min = 6 orë të plota; plus 12 orë të kalkuluara për takime reflektuese/planifikuese dhe zbatim të instrumenteve të vlerësimit me nxënës).

Kriteret për certifikim janë:

- Së paku 90% pjesëmarrje në sesionet kontaktuese dhe në takimet reflektuese me fasilitues;
- Realizimi i instrumenteve të vlerësimit me nxënës sipas udhëzimeve nga kursi;
- Prezantimi i raportit të vlerësimit me gojë para fasilituesve dhe pjesëmarrësve të trajnimit.

Materialet e trajnimit

- Udhëzuesi për fasilitues të programit trajnues së bashku me fletat e punës;
- Sllajdet në Power Point dhe Video prezantimet.